



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 125, datë 15.07.2019**

**MBI**  
**VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE PER REKRUTIMIN SI**  
**GJYQTARE TE KANDIDATES {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 15.07.2019, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare të kandidatës {...} , pasi dëgjoi relacionin përkatës të relatorit të çështjes dhe shqyrtoi materialet e saj,

**KONSTATOI:**

1.Kandidatja {...} është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018 dhe për këtë shkak iu nënshtrua verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit si gjyqtare në kuptim të nenit 32 dhe 35 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë".

2. Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatës {...} filloi me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, datë 05.06.2019, nëpërmjet të cilit, me short, si relator u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro .

3. Kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit dhe për relatorin e çështjes, duke mos paraqitur ai asnjë kërkesë për përjashtim ose pretendim në lidhje me të ose me ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Kandidatja u njoftua rregullisht për dokumentacionin që duhet të plotësonte dhe dorëzonte në kuadër të procedurës së verifikimit, duke e plotësuar dhe dorëzuar atë në afatet e përcaktuara.

5.Në kuadër të procedurës së verifikimit u administrua dokumentacioni përkatës me të dhënat e nevojshme për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në korrespondence me subjektet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë."

6. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë procedurës së verifikimit u konstatua se kandidatja {...} plotëson kushtin për t'u emëruar si gjyqtare në bazë të nenit 35 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republikën e Shqipërisë", ndërsa ajo është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018.

7. Kandidatja {...} rezultoi se përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, edhe të

emërimin si gjyqtare, duke mbajtur në konsiderate për këtë ligjin e kohës së pranimit të saj në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996, "Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dalë në zbatim të këtij ligji, ashtu sikundër edhe ligjin aktual në fuqi, konkretisht nenin 28 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë".

7.1 Kështu, u verifikua se kandidatja:

- a) ka zotësi të plotë për të vepruar, ndërsa nuk ka të dhëna për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prere;
- b) është shtetase shqiptare, referuar të dhënave për përbërësit e gjendjes civile të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- c) ka plotësuar kriterin arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996, "Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë", verifikuar nga Shkolla e Magjistraturës në momentin e pranimit në formimin fillestar në vitin akademik 2015- 2016;
- d) nuk ka të dhëna të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- dh) nuk rezultojnë të jetë e larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo të ketë masë disiplinore në fuqi;
- e) nuk ka të dhëna të jetë anëtare e partive politike;
- e) nuk mund të ketë qene anëtare, bashkëpunëtoresh ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, referuar moshës së saj (e datëlindjes 22.02.1988);
- f) nuk ka të dhëna për qenien e saj bashkëpunëtoresh, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

8.Kandidatja {...} rezultoi se përmbush kriteret e emërimit si gjyqtare sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë".

8.1 Kështu, u verifikua se kandidatja:

- a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 92,49% të pikëve, pra *"është diplomuar më të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme"*;
- b) është vlerësuar me maksimalen e pikëve (600), domethënë "shume mire", për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra "është vlerësuar minimalisht *"mire "për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar"*.

9. Kandidatja {...} rezultoi të kalojë testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë".

9.1 Kështu, nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me pasurinë e kandidatës, nuk rezultoi që ajo të jete përpara ndonjë prej rasteve të skualifikimit nga kandidimi, pra që:

- a) burimet financiare të kandidatës të mos justifikojnë pasuritë e saj;
- b) kandidatja të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;
- c) kandidatja të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- d) kandidatja të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

10. Kandidatja {...} rezultoi të kalojë testin e verifikimit të figurës sipas shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë".

10.1 Kështu, nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me figurën e kandidates, nuk rezultoi që ajo të jetë përpara ndonjë prej rasteve të skualifikimit nga kandidimi, pra që kandidatja :

- a) të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- b) të ketë lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) të ketë qene anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr.45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- d) të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës

11. Bazuar sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor konkludoj se për kandidaten {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtare, prandaj është vendi për kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

12. Sa më sipër, bazuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 97, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në nenin 35, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në shkronjën "b", të pikës 12, të Seksionit Q, të Kreut VI, të Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidateve për gjyqtare, për zhvillimin e karrierës së gjyqtareve dhe për emërimin e gjyqtareve të Gjykatës së Lartë", Këshilli i Lartë Gjyqësor,

#### VENDOSI:

1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...} , e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQESOR**